

MINISTRIA E BRENDSHME
REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
TETOR - DHJETOR 2024

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
23	24.09.2024	Kërkesë për informacion nga një shtetas lidhur me financimin shtesë, në masën 100 milion lekë, për projektet e reja në Ministrinë e Brendshme, në zbatim të marrëveshjes Shqipëri-Itali për protokollin për migracionin.	17.10.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj lidhur me miratimin e Aktit Normativ nr. 3, të datës 28.08.2024 ku përfshihen edhe fondet që kanë të bëjnë me financimin në mbështetje të Ligjit nr. 20/2024 “Për ratifikimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane, për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit”, sqarojmë se: fondi i kërkuar nga Ministria e Brendshme në kuadrin e rishikimit të buxhetit me Aktin Normativ ishte në shumën 289 milion lekë ku përfshiheshin blerje pajisje, armatim dhe mjete transporti; në fondin e miratuar me Aktin Normativ nr. 3 në shumën 100 milion lekë, janë financuar blerje pajisje armatimi ndërsa blerja e mjeteve të transportit	E plotë	Nuk ka

				do të financohet në vitin 2025 për arsye të kohës së nevojshme që kërkojnë procedurat e prokurimit për blerjen e tyre. Çdo shpenzim për personelin dhe logjistikën për njësinë policore që operon në strukturat pritëse për migrantët do të rimbursohet nga pala italiane.		
24	15.10.2024	Kërkesë nga Rrjeti për Raportimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Shqipëri për informacion dhe vënie në dispozicion dokumente në lidhje me ankandin e zhvilluar më datën 04.07.2023 për një pasuri të administruar nga AAPSK.	15.10.2024	Kërkesa iu dërgua për ndjekje dhe kompetencë AAPSK dhe subjektit i është kthyer përgjigje nga vetë ky institucion.	E plotë	Nuk ka
25	19.10.2024	Kërkesë për informacion nga Studio Ligjore ONIX lidhur me procedurën dhe protokollin e shoqërimit të personaliteteve të larat.	25.10.2024	Bazuar në informacionin e përcjellë nga Departamenti për Sigurinë Rugore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, rezulton se në datë 04.10.2024, rreth orës 17:30, shërbimet e Policisë Rugore të Njësisë së Sigurisë së Autostradës Milot-Morinë, kanë qenë në shoqërim stafetë të “Ministrit të	E plotë	Nuk ka

				Brendshëm të Maqedonisë së Veriut”, së bashku me shërbimet e Gardës së Republikës së Shqipërisë. Gjatë shoqërimit Salla Operative e Gardës së Republikës së Shqipërisë ka njoftuar Sallën Operative të Policisë Mirditë dhe Sallën Operative të Policisë Lezhë lidhur me një automjet, i cili u konstatua të qarkullonte gjatë gjithë kohës në afërsi të eskortës, prej vendit të quajtur “Fushë Mamurras”, i pa autorizuar dhe i pa identifikuar prej trupës së shoqërimit. Pasi u bë i mundur ndalimi i automjetit me targa xxx, me drejtues shtetasin xxx, janë kryer verifikimet përkatëse dhe veprimet proceduriale për marrjen e masave nga patrulla e shërbimit, si dhe i është komunikuar shkelja drejtuesit të automjetit pasi u përpilua procesverbali i konstatimit të shkeljes sipas ligjit Nr.8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”. Shërbimi për sigurinë e personaliteteve të larta organizohet, planëzohet e kryhet	
--	--	--	--	--	--

				në bazë të ligjit “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” dhe akteve ligjore e nënligjore, që normojnë veprimtarinë e Gardës.		
26	12.10.2024	Kërkesë nga një gazetar i një rrjeti investigativ për kopje të marrëveshjes për projektin “Smart city” mes Shqipërisë dhe EBA.	21.10.2024	Në datën 23 prill 2024 Ministri i Brendshëm, z. Taulant Balla zhvilloi një vizitë zyrtare në Emiratet e Bashkuara Arabe me homologun e tij z. Saif bin Zayed Al Nahya, ku u diskutua mbi çështjet e bashkëpunimit dypalësh në fushën e krimit të organizuar dhe sigurisë. Në kuadër të bisedimeve lidhur me çështjet e sigurisë, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit për projektin “Smart City”, i cili përmes përdorimit të Inteligjencës Artificiale dhe Sistemit të Analizimit të të Dhënave, synon rritjen e efikasitetit dhe qëndrueshmërinë urbane, përmirësimin e sigurisë publike duke parandaluar dhe dokumentuar veprat penale nëpërmjet investimeve teknologjike. Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua bazuar në ligjin Nr. 145/2020	E plotë	Nuk ka

				“Për Ratifikimin e Marrëveshjeve për Bashkëpunimin Ekonomik Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe”. Duke respektuar termat e nënshkrimit dhe detyrimet që rrjedhin nga ky Memorandum Mirëkuptimi, konkretisht bazuar në nenin 7 të tij, “Konfidencialiteti, thuhet se: “Palët bien dakord që secila duhet t’i trajtojë në mënyrë konfidenciale termat dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje dhe të gjithë informacionin e dhënë nga secila palë ndaj tjetrës lidhur me zhvillim e këtij projekti”, për këtë arsye e kemi objektivisht të pamundur vendosjen në dispozicion të kopjes së kësaj marrëveshjeje. CC: Komisioneri për të Drejtën e Informimit		
27	24.10.2024	Kërkesë nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe të Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me ankimin e	01.11.2024	Kërkesa për informacion lidhur me marrëveshjen e nënshkruar gjatë vizitës së ish Ministrit të Brendshëm, z. Taulant Balla në	E plotë	Nuk ka

		një gazetari me lëndë: “Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare lidhur me projektin ‘Smart City’”.		Emiratet e Bashkuara Arabe është trajtuar në përputhje me përcaktimet që rrjedhin nga marrëveshja, konkretisht në nenin 7 të saj, “Konfidencialiteti”, sipas së cilit: “Palët bien dakord që secila duhet t’i trajtojë në mënyrë konfidenciale termat dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje dhe të gjithë informacionin e dhënë nga secila palë ndaj tjetrës në lidhje me biznesin dhe operacionet e saj. I gjithë informacioni konfidencial i dhënë nga një pjesë e këtij dokumenti duhet të përdoret nga çdo pjesë tjetër e këtij dokumenti vetëm për qëllimin e ofrimit ose marrjes së shërbimeve në përputhje me këtë marrëveshje dhe përveç rasteve kur është e nevojshme në ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje, duhet t’i zbulohet palëve të treta pa pëlqimin paraprak të palës furnizuese.” Nga objekti dhe qëllimi i marrëveshjes kërkuesi nuk përbën subjekt të ekzekutimit të saj. Gjithashtu, bazuar në kufizimet që referohen në nenin 17 të ligjit nr.	
--	--	---	--	---	--

				119/2014 “Për të drejtën e informimit” kemi vlerësuar mbajtjen e qëndrimit sipas kthimin të përgjigjes të datës 21.10.2024 duke i vendosur në dispozicion kërkesit një përmbledhje të detajuar mbi natyrën dhe qëllimin e projektit Smart City, si edhe informacionin dhe dokumentacionin përkatës lidhur me ngritjen e taskë forcës së përbashkët në luftën kundër krimit të organizuar. CC: Komisioneri për të Drejtën e Informimit		
28	24.10.2024	Kërkesë për informacion mbi disa përbërës të tregut të përbashkët rajonal, që janë nën kompetencën e Ministrisë së Brendshme.	20.11.2024	Marrëveshja për kushtet e aksesit të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor ka filluar zbatimin për sa i përket shtetasve të vendeve palë që kërkojnë të kenë akses të lirë në tregun shqiptar të punës. Në këtë drejtim dhe në përputhje me protokollin zbatues po aplikohen kritere dhe dokumentacion i unifikuar për shtetasit e huaj, të pajisur me ID Open Ballkan, reflektuar edhe në platformën e-Albania përmes formularit të aplikimit për leje unike. Janë integruar dispozita rregulluese në disa akte nënligjore dalë në	E plotë	Nuk ka

				zbatim të ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt”... Lidhur me pyetjen nëse ka marrëveshje me gjashtë vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor për lehtësimin e procedurave për punonjësit ndërkufitar në përputhje me nenin 6, pika 10 e ligjit "Për të Huajt", dokument ndërkufitar që lehtëson kalimin dhe qëndrimin e punonjësve, ekziston “Marrëveshja për Lirinë e Lëvizjes me Kartë Identiteti në Ballkanin Perëndimor”, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 55, datë 1.2.2023 Sa i përket çështjeve dhe të dhënave që lidhen me bizneset dhe punësimin, lutemi t'i drejtoheni Ministrisë për Ekonominë, Kulturën dhe Inovacionin. Bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni të dhënat e kërkuar për lejet e qëndrimit, si edhe një kopje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 55, datë 1.2.2023 “Për Miratimin e Marrëveshjes për Lirinë e Lëvizjes me Kartë”.		
29	11.11.2024	Kërkesë nga një shtetase lidhur me disa	25.11.2024	Lidhur me kërkesën tuaj për informacion mbi numrin e	E plotë	Nuk ka

		statistika për shtetasit e huaj mbi 60 vjeç që kanë marrë nënshtetësinë Shqiptare.		shtetasve të huaj, mbi 60 vjeç që kanë fituar shtetësinë shqiptare në 10 vitet e fundit, sqarojmë se: dekretimi është detyrë funksionale e Presidentit të Republikës, ndaj lutemi t'i drejtoheni Institucionit të Presidentit të Republikës.		
30	12.11.2024	Kërkesë nga emisioni investigativ STOP për gjetjen e një certificate vdekjeje me pretendimin se ndodhet në arkivën e Ministrisë së Brendshme.	13.11.2024	Në vijim të e-mailit tuaj ju informojmë se, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në Ministrinë e Brendshme nuk administron dokumente të akteve të gjendjes civile. Bazuar në shkronjën b, të nenit 67, të "Ligjit për Gjendjen Civile", institucioni përgjegjës për administrimin e arkivit të regjistrave dhe akteve të gjendjes civile është Zyra e Gjendjes Civile pranë Prefektit të Qarkut, në rastin konkret është Zyra e Gjendjes Civile pranë Prefektit të Qarkut Durrës. Pas verifikimit të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në Ministrinë së Brendshme për rastin në fjalë, rezulton që qytetarit t'i jetë kthyer përgjigje.	E plotë	Nuk ka

31	14.11.2024	Kërkesë nga Rrjeti për Raportimi e Krimit të Organizuar dhe të Korrupsionit në Shqipëri, për vënien në dispozicion të informacionit dhe dokumentacionit lidhur me pajisjen me vizë turistike dhe punë për nënshtetasit e huaj nga Egjipti, Siria, Palestina, Bangladeshi, Iraku dhe Jemeni për periudhën nga 2020- tetor 2024.	30.11.2024	Në vijim të e-mailit tuaj, bashkëngjitur po ju dërgojmë të dhënat për vizat e punësimit dhe ato turistike, për periudhën kohore 2020-2024 sipas shteteve që keni kërkuar. Faleminderit. (Informacioni është dërguar bashkëngjitur e-mailit në formatin excel).	E plotë	Nuk ka
32	27.11.2024	Kërkesë për informacion lidhur me konsultimin e dokumentit të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 dhe planin e saj të veprimit 2023-2025, nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.	04.12.2024	Projekti është konsultuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për periudhën kohore 9 dhjetor 2022 deri më datë 25 janar 2023, në respektim të afatit ligjor. Dokumentet të cilat u vendosën në dispozicion për tu konsultuar kanë qenë: Projektvendimi; Relacioni shpjegues; Dokumenti i Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030; Njoftimi për konsultim publik;	E plotë	Nuk ka

				Raporti final i konsultimit publik. Metodat e konsultimit të përdorura për projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2023 - 2030, dhe të planit të saj të veprimit 2023 - 2025”, ishin: Mekanizmi IPMG; Konferenca (reflektuar në tabelën bashkëlidhur); Takime konsultative (reflektuar në tabelë bashkëlidhur); Takime të grupit të punës, referuar urdhrat të grupi ndërinstitucional të punës, i cili u kryesua nga Zëvendësministri i Brendshëm, përgjegjës për koordinimin e vetëqeverisjes vendore. Aktorët e jashtëm të cilët u përfshinë në procesin e konsultimit të draft dokumentit ishin: Shoqata për Autonominë Vendore; IDM; IDRA; Aleanca Kombëtare e Këshilltareve; Ambasada Zvicerane dhe Ambasada Austriake. Lidhur me ftesat për takime konsultative	
--	--	--	--	---	--

				të zhvilluara fizikisht ose në platformat online është objektivisht e pamundur të vihet në dispozicion një ftesë e-maili në këtë moment, pasi punonjësit të cilët kanë qenë të ngarkuar me mirëmenaxhimin e komunikimeve, janë larguar nga detyra. Raporti final i konsultimit publik të aktit, gjendet në faqen e konsultimit publik, për lehtësinë tuaj po ju a përcjellim bashkëlidhur.		
33	02.12.2024	Kërkesë për informacion nga një shtetase lidhur me sigurinë e nxënësve pasagjerë gjatë transportit në shkollat publike dhe private.	16.12.2024	Kuadri rregullues për transportin e nxënësve, bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1101 datë 28.12.2015, “Për miratimin dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe të studentëve”. Përmbushja e standardeve të sigurisë nga operatorët e transportit shkollor, monitorohet nga shërbimet e Policisë Rrugore, nëpërmjet kontrolleve të drejtpërdrejta në rrugë mbi zbatimin e normave dhe kushteve të	E plotë	Nuk ka

				qarkullimit, si dhe nga Drejtoria e Përgjithme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, mbi kontrollet periodike për kushtet teknike dhe të sigurisë së mjeteve të cilat kryejnë këtë lloj transporti.		
--	--	--	--	---	--	--